



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : Njësia administrative Bërdicë.

Data : 12.09.2025 **Ora :** 15.00 **Vendi:** Shkolla “Agim Tafili”

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesmarrësve 32, nga të cilat 6 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga zv.Kryetari i Bashkisë Shkodër Z.Rudin Beka i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ♦ Projekt-aktin e propozuar
- ♦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ♦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ♦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ♦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :

Në fillim fjalën e merr Kryetari i Njësisë Administrative, i cili hap takimin në kuadër të dëgjesave publike. Ai shton se po perpiqemi të realizojmë sa mundemi dhe bën një përbledhje të punëve të kryera në Njësine administrative të Bërdicës.

Po ashtu edhe Zv. Kryetari, z.Beka bën një analizë të shkurtër të punëve që janë bërë dhe fton pjesëmarrësit të flasin për priorititetet dhe shqetësimet e tyre. Ai shton se jemi të hapur për të diskutuar rreth mundësive dhe nevojave që ka zona. Si për ndërhyrje afatshkurta ashtu edhe për investime të mëdha për të gjetur mundësinë për ti realizuar.

Z. Fillip Toma, banor fshati Beltojë:

- Rruga e Beltojës, e cila është prishur nga OSHEE për instalim të 20 KË, duhet të komunikohet me OSHEE-në dhe firmën zbatuese të ketij investimi, që të rregullojnë rrugën pasi është lënë e papërfunduar..
- Uji i pijshëm në zonën e Beltojës mungon, kemi 30 vite qe nuk kemi ujë.

Z. Aleksander Pashuku:

Sqaron se projekt i rrugës që u diskutua është që tre vite i bërrë duhet përfshirë edhe disiplinimi i ujrave të bardha, rreth 250 metra rrugë dhe projekt i është i gatshem. Shpimi është i bërrë për ujin në zonën e Beltojës në mënyrë që të bashkohet me ujësjellësin e Trushit.

- Për zonën e Beltojës po behet linja elektrike dhe duhet të komunikohet me OSHEE-në për të bërrë lidhjen për pompat e ujit për shtëpitë e gjithë fshatrave të zonës.
- Në lidhje me ndriçimin është punuar, gjithashtu janë pastruar kanale dhe është investuar në kanale ujtitëse.
- Rruga kryesore e Bërdicës që lidh 5 -6 fshatra, është shumë e nevojshme që të rregullohet.
- Fusha e sportit po ashtu ka nevojë për investim, duhet parë mundësia që ky investim të kryhet nga Bashkia, pasi fusha nuk ka sipërfaqen e duhur për tu investuar nga FSHF-ja.

Z. Kujtim Çekorja, banor fshati Bërdicë e mesme:

- Rruga kryesore Bërdicë e mesme, ka nevojë për ndërhyrje.
- Rruga Muhja dhe rruga e varrezave po ashtu.

Z. Xhelal Myrtja, Kryeplak fshati Bërdicë e mesm

- Ju falenderojmë së pari, se në zonën tonë janë bërrë disa punë të mira, është pastruar një kanal që e kemi pasur prioritet si dhe janë veshur dy rrugë me asfalt.
- Kemi rreth 400 metra rrugë në Bërdicë që ka nevojë për investim.
- Po ashtu edhe rruga "Rexhep Selimi" me një gjatësi prej 500 metresh ka nevojë për ndërhyrje dhe kjo është kërkueshme.
- Një pjesë e ndriçuesave duhet te lidhen, janë në shtylla por thjesht duhet bërrë lidhja me tel.

- Kemi edhe një problem me një rrugë, prej të cilës nuk mund të aksesojmë në disa parcela që kemi përfituar me ndarjen e pronave.
- Kemi kanale që kanë nevojë për tombina.

Z. Bujar Ferracaku, drejtor shkolla “Frederik Gjoni”:

- Shkolla ka nevoja të mëdha në fakt por prioritare kemi rrëthimin e shkollës. Është emergjente.
- Tavani dhe streha e shkollës kanë nevojë për ndërhyrje dhe riparim.
- Gjithashtu dyert dhe dritaret kanë nevojë për sistemim sepse janë të prishura dhe të rrezikshme duke qenë se janë plastike.

Znj. Besa Muji, drejtoresha e shkollës “Seit Cen Tagani” Trush:

- Kemi një godinë të mbajtur mirë falë prindërve dhe familjarëve të cilët kanë investuar në mirëmbajtje vetë.
- Kemi nevoje urgjente për ndërhyrje në tualete e nyje sanitare, janë në gjendje të amortizuar dhe totalisht të papërdorshme.
- Bombulat e fikjes së zjarrit janë hequr para një viti dhe akoma nuk janë zevendesuar.
- Dritaret gjithashtu janë të dëmtuara dhe sa po bie shi kemi prezencë ujë në klasa.
- Nuk kemi ujë të pijshëm.
- Kemi numër të madh fëmijësh në kopësht dhe është e nevojshme të kemi mësues mbështetës për fëmijët me aftësi ndryshe.
- Secili grup ka kaluar numrin 20 dhe duhet të shtohen edhe edukatorët në këtë kopësht.

Znj. Vjoleta Hoxha, drejtoresha e shkollës “Agim Tafili”:

- Është bërë rrëthimi i shkollës dhe gjithashtu lyerja e jashtme e saj. Kemi problematika edhe me tualetet sidomos ka shumë lagështirë dhe duhet medeemos të ndërhyhet.
- Me hapësirën që është krijuar nga prishja e shkollës së vjetër është mundësia për të bërë investim për një kënd sportiv. Kemi rreth 110 nxënës dhe 30 fëmijë të kopshtit, prandaj është e nevojshme të kemi kënd sportive.

Sqaron Z.Gjozef Kullaj, nga administratë e Bashkisë, duke thënë se ndërtimi i një këndi sportiv është aplikuar si projekt pranë Ministrisë.

Z. Sabah Hoxha, banor fshati Bërdicë e mesme :

- Kemi një bllok pronash bujqësore të cilat nuk kanë akses me rrugën, pasi janë të zëna, duhen verifikuar dhe dhënë zgjidhje sepse na ndihmon shumë.

- Me ligjin 7501, një pronë e imja është marrë nga rruga, personi që e ka tokën thotë që është e imja por akoma nuk kemi marrë shpronësimet.
- Kemi një kanal që është hapur prej 5 vitesh dhe kemi nevojë të ndërhyhet.

Z. Julian Frani, kryetar fshati Malihebaj:

- Janë bërë ndërhyrje në zonë për kanale dhe ndriçim.
- Kemi emergjente ndërhyrjen për ujin e pijshëm. ka dëmtime të rrjetit dhe duhet që dikush të ndërhyje.
- Rrga nga Beltoja në Bërdicë të madhe ka nevoje për ndërhyrje me riparime pa shumë kosto.
- Tjetër problematikë e disa banorëve të zonës është se ujësjellësi i ka shkëputur furnizimin me ujë por nuk i kanë mbyllur kontratat e ujit duke lënë shumë gjoba me kamate. Duhet të ketë një ndërhyrje sepse edhe nuk kemi ujë edhe duhet të paguajmë detyrime dhe gjoba nga ujësjellësi.

Z. Shpresim Tula, Trush:

- Rrga e Ballamanit nuk është shtruar kurrë dhe nuk ka patur asnjë investim. Është rrugë e cila e ka projektin të bërë.
- Rrga Drita në Trush, rreth 420 metra, të shihet mundësia për financim sepse është prioritet për ne.

Z. Xhabir Milla:

- Kemi dy probleme kryesor; Nga harku i Bërdicës për në Bahçallek kanë qenë me përpara 3 metra kanale ndërkohe janë 6 të pakompensuara.
- Për rrerrotullimin në këtë zonë, nuk kemi asnjë informacion dhe as dijeni se ku kalon.
- Rrga e varrezave në Bërdicë të sipërme është e paasfaltuar, rreth 3 km rrugë.
- Mbikalimet gjithashtu duhet të bëhen në këtë rrugë sepse janë të nevojshme për ne.

Aleksander Pashuku, sqaron se rruga nga Beltoja për në rrugën kryesore duhet të keteë ndërhyrjen e duhur për në rrugën mes Malihebaj sepse nuk është vetëm mbyllje gropash por duhet të ketë një investim me FSHZH sepse është rrugë e nevojshme edhe gjatë sezonit të verës. Por duhet që edhe ne banorët të biem dakort për të liruar avullitë në këtë rruge sepse në shumë vende është e zënë. Ai shton se:

- Duhet të shihet rruga tek harku i Bërdicës dhe në Bahçallek, për mënyrën se si do futemi dhe të dalim në këtë rruge.
- Problem tjetër për ne janë shpronësimet për këtë rrugë, pasi nuk kemi asnjë informacion se çfarë do bëhet me tokat tona të marra nga rruga e të pashpronësuara.
- Edhe çmimi që është vlerësuar kjo pronë e marrë, është vlerë shumë e ulët dhe nuk ka mundësi të paguhet kaq pak kjo pronë

- Përsa i përket rezervuareve që kemi në zonë, nuk kemi as uje, as ka roje, asgjë.

Z. Xhavit Pëllumbi, sqaron se jemi ndër njësitë më përfituese për grantin e sistemit ujitës rrëth 1.1. mln euro. Impakti i këtij investimi ka rrit me 1000 hektare mundësinë për ujitje. Por banorët këto investime duhet ti mirëmbajnë dhe të kujdesen për to. Nuk i kushton asgjë asnjërit nga ne të pastrojmë dhe të mirëmbajmë këto kanale nga bimësia.

- Kërkesat tona për Bashkinë kanë të bëjnë me rrugët dytësore lidhëse që janë rrugë me kalldrem të vjetër dhe kanë nevojë për çakull e stabilizant për të aksesuar në tokat e fermerëve.
- Kemi dy kanale në të cilat duhet të ndërhyhet. Janë kanale që kanë lidhje me lumen Drin.

Z. Reshit Rexhepi :

- Muri i shkollës “Frederik Gjoni” është shumë emergjent.
- Tek rruga e shkollës është e rëndësishme të kemi një stacion për ndalesën e furgonit dhe autobuzit sepse është shumë e rëndësishme, pasi kemi patur edhe humbje jete fëmijësh.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Beka, zv.Kryetari i Bashkisë** mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

SEKRETARI

Sabina Danaj

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Memë

Irma Sulishti

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

LISTË PREZENCË
(*Njësia Administrative Bërdicë*)

KONSULTIM PUBLIK: "Për Miratimin e Projekthuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër"

Date: 12.09.2025

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Aleksander Rezuci	Bërdicë	0673021690		
2.	Anila Barbuusha	Br. Asimore	0674060881	anilabarbuusha18@gmail.com	
3.	Hoxha Hoxha	Bërdicë kthesme	069828188		
4.	Besëri Pëllumbi	Dreashkollës Tuziq	0676343102	besepellumbi1@gmail.com	
5.	BURAR FERENCANU	Bërdicë Maçalle	0674617508		
6.	Kujtim Lekorja	Bërdicë Mesnë	0697302192		
7.	Tirën Toma	Bërdicë	0693718132		
8.	Bendix Dhermi	Bërdicë	0693892543		

NR.	EMRI/MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9.	Selvjet Shomoni	Pracnic	0674828104		
10.	Gorment Rekha	Turash	06728649194		
11.	Julian Tukan	MNH-HEB	0674807832		
12.	Enver Rjeti	Besipuane	0684134030		
13.	Groshjet Seljimi	Berdić-SIP	06733957126		
14.	Fatbardh Kus	NSHPO	062630501		
15.	Ezherit Pshuri	Turska	0676343132		
16.	Afreet Shabeta	NSHPO	067881633		
17.	Zekret Miftiq	Kolek Blesar	0682449966		
18.	Ramis Aleti	Besidice e Madhe	0699057608		
19.	Kast. Is. Gjermani	Berlise e Malje	069526058		
20.	Egli Shabanxhaj	Sh Koled	0674614441		
21.	Veliqje Tulin	Besidice e Madhe	0699459557		
22.	Ardiza Velja	Berdic e Sipunne	0673087070		
23.	Flavio Blaslocaj	B.S. SHKODER	0684063501		
24.	Altin Gjeka	Trush	0699759585		
25.	Afim Sheshaku	Bunoli	0685670822		
26.	Sekuhedin Hoxhe	Besidice	0692237688		
27.	Zo iker Egli	NAUTIBI	0682490914		
28.	Findina Shkodra	YPLHBO	0684615266		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
29.	Shkelzen Cekolla	Berdikemësme	0684602957		
30.	Arija Resnje	Bardh e Mesn	0683118201		
31.	Lindja Hoxha	Bishtësi Me	06833207754		
32.	Hysen Rilaci	069247711			